



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 31.03.2023

Nr: 39

Ora: 14:10

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 41, DATË 30.03.2023, DEPOZITUAR NGA PARTIA "ALEANCA E MAQEDONASVE PËR INTEGRIM EUROPIAN"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 31.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA - **Relator**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia "Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian"

OBJEKT: Kundërshtim për mospranimin e dokumentacionit të listës shumëmemërore të Partisë "Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian" nga KZAZ-ja nr. 71, Bashkia Pustec

BAZË LIGJORE:

Nenet 21/c, 123/1, 126 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 9 dhe 10, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 41 regi., datë 31.03.2023.

Në mbledhjen e datës 31.03.2023, ora 14:10, pas relatimit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 41 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 41, datë 31.03.2023 të paraqitur nga Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian”.

2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 03.04.2023 ora 11:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvis ÇEFA - **Relator**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**